



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 734 prot.

Tiranë më, 13.05.2020

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 07, datë 13.05.2020

**PËR
RRITJEN E EFEKTIVITETIT TË VEPRIMTARISË SË SHËRBIMIT TË
EKSPERTIZËS**

Në mbështetje të neneve 148 pikat 1, 2, 3 dhe 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronjat “b” e “f”, 42 shkronja “a”, “g”, 43, 46 pika 2 shkronja “ç”, 48 e 67 të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 24, 25 pika 2, 103, 176, 177, 184, 279 e vijues Kodit të Procedurës Penale i ndryshuar, neneve 101 pika 1 shkronja “a” e 102 pika 1 shkronjat “ç”, “j”, “ll”, e vijues të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neneve 2, 4, 6 pika 2, 18 pika 3 shkronja “b”, 21 pika 3, 28 e vijues të ligjit nr.9828/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe urdhërit nr.29/1, datë 03.02.2020 “Për caktimin e strukturës faktike në Prokurorinë e Përgjithshme”,

U D H Ë Z O J:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi të përgjithshëm është për të unifikuar ushtrimin e funksioneve me efektivitet nga shërbimi i ekspertizës në Prokurorinë e Përgjithshme, i

cili siguron konsulta teknike dhe asistencë apo këshillime, mbi kërkesat e prokurorëve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si për procedime apo çështje penale në fushat ekonomike, financiare, bankare, kontabël, fiskale (doganore e tatimore) dhe auditimit të brendshëm publik, ashtu dhe për procedime apo çështje penale në fushat inxhinieriko-mekanike, autoteknike, qarkullimit dhe/ose sigurisë rrugore apo vlerësime dëmi material në këto fusha, si dhe në fusha të tjera të shkencës.

2. Ky udhëzim ka për qëllim, gjithashtu, për të forcuar ligjshmërinë dhe rritur efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale, si ndaj krimit ekonomik e financiar, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshi dhe hetimet pasurore sipas fushave, ashtu dhe ndaj veprave penale në fushën e qarkullimit, transportit dhe sigurisë rrugore.

Neni 2

Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:

a) Përcaktimi i llojeve të konsultave teknike, metodologjike dhe/ose asistencës apo këshillimeve që siguron shërbimi i ekspertizës, sipas fushave përkatëse, në fazat e procedimit penal.

b) Përcaktimi i mënyrës dhe llojeve të komunikimit ndërmjet prokurorëve me ekspertët e shërbimit të ekspertizës, si dhe i formës e përmbajtjes së aktit përkatës të këtij shërbimi dhe vlerës së përdorimit të tij.

c) Përcaktimi i rregullave, për ruajtjen e sekretit hetimor, ndalimin e publikimit të akteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në komunikimet ndërmjet prokurorëve me ekspertët e shërbimit të ekspertizës.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë udhëzim, termat apo emërtimet kanë kuptimet, si më poshtë:

1. “Shërbimi i ekspertizës” është pjesë e strukturës së Prokurorisë së Përgjithshme që siguron konsulta teknike dhe asiston apo këshillon prokurorët në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, e cila aktualisht përbëhet nga:

a) Ekspert në fushat ekonomiko-financiare e audituese, për çështje ekonomike, financiare, bankare, kontabël, fiskale (doganore e tatimore) dhe auditim të brendshëm publik;

b) Ekspert në fushat inxhinieriko-mekanike, transportit e sigurisë, qarkullimit e sigurisë rrugore, për çështje inxhinieriko-mekanike, autoteknike, qarkullimit dhe/ose sigurisë rrugore apo vlerësime dëmi material në këto fusha.

KREU II

**SIGURIMI I ASISTENCËS DHE KONSULTAVE TEKNIKE APO
METODOLOGJIKE
NË FAZAT E PROCEDIMIT PENAL**

Neni 4

Faza fillestare e hetimeve

1. Drejtuesi i prokurorisë për prokurorët e prokurorisë që drejton dhe/ose drejtuesi i seksionit për prokurorët e seksionit që drejton, në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje prokurorit, si për vepra penale në fushat ekonomike, financiare, bankare, kontabël, fiskale (doganore e tatimore), auditimit të brendshëm publik dhe për hetimeve pasurore sipas fushave, ashtu dhe për vepra penale në fushat inxhinieriko-mekanike, autoteknike, qarkullimit dhe/ose sigurisë rrugore apo vlerësime dëmi material në këto fusha, kur e vlerësojnë të nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit/çështjes për këto vepra, nxjerrin udhëzime jo të detyrueshme me shkrim për prokurorin përkatës, ku veç të tjerave mund të udhëzojnë, duke arsyetuar nevojën për të kërkuar konsultë teknike me ekspertët e shërbimit të ekspertizës për të qartësuar mekanizmin e kryerjes së veprës penale të kallëzuar apo referuar dhe/ose konsultë metodologjike për të qartësuar llojet e provave, mënyrën e kërkimit dhe vendndodhjen e mundshme për gjetjen dhe/ose zbulimin e tyre, të cilat mund dhe/ose duhet të administrohen në hetim dhe/ose të bëjnë kërkime teknike të nevojshme për të siguruar informacione shtesë për procedimin penal, për të garantuar një hetim të plotë e të gjithanshëm, në kuadrin e një procedimi të drejtë dhe të rregullt ligjor.

2. Prokurori i çështjes në fazën fillestare të hetimeve paraprake, kur e vlerëson të nevojshme, dhe/ose në zbatim të udhëzimit jo të detyrueshëm të drejtuesit, mund të kërkojnë konsultë teknike për të qartësuar mekanizmin e kryerjes së veprës penale të kallëzuar apo referuar dhe/ose konsultë metodologjike për të qartësuar llojet e provave, mënyrën e kërkimit dhe vendndodhjen e mundshme për gjetjen dhe/ose zbulimin e tyre, të cilat mund/duhet të administrohen në hetim dhe/ose të bëjnë kërkime teknike të nevojshme për të siguruar informacione shtesë për procedimin penal, për të garantuar një hetim të plotë e të gjithanshëm, në kuadrin e një procedimi të drejtë dhe të rregullt ligjor.

3. Në rastet kur vlerësohet nga prokurori i çështjes, mund të kërkohet që eksperti përkatës i shërbimit të ekspertizës të asistojë prokurorin ose oficerin e policisë gjyqësore të urdhëruar/autorizuar prej tij sipas ligjit, në veprimet që mund të autorizohet prania e ekspertit, siç mund të jenë, në kryerjen e eksperimentit dhe/ose në pyetjen e palëve apo marrjen e provave me anë të përdorimit të mjeteve të posaçme teknike ose kur marrja e tyre kërkon njohuri të specializuara në fushat përkatëse.

Neni 5

Faza e hetimeve

1. Prokurori i çështjes, në fazën e hetimeve paraprake, kur e vlerëson të nevojshme kryerjen e ekspertimit, mund të kërkojë konsultë teknike me ekspertin përkatës të shërbimit të ekspertizës, për të qartësuar llojin/emërtimin e ekspertimit më efektiv dhe cilësitë e veçanta që duhet të ketë eksperti i fushës përkatëse dhe/ose konsultë metodologjike për të qartësuar pyetjet e përgjithshme dhe/ose specifike që mund ose duhet t'i drejtohen ekspertit apo grupit të ekspertëve për përgjigje, si dhe materialet hetimore që mund t'i vihen në dispozicion të tij, për të siguruar një akt-ekspertimi të pritshëm me përshkrim dhe me konkluzione të sakta, të plota, të qarta e të arsyetuara për çështjet teknike për të cilat kërkohet kryerja e ekspertimit përkatës.

Neni 6

Përfundimi i akt-ekspertimit

1. Në fazën e përfundimit të akt-ekspertimit dhe administrimit të tij në prokurorinë përkatëse, prokurori i çështjes kur e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë këshillim me ekspertin përkatës të shërbimit të ekspertizës, për të analizuar dhe vlerësuar aspekte teknike të anës formale, përmbajtjes dhe konkluzioneve të akt-ekspertimit, për të qartësuar:

a) Nëse akt-ekspertimi plotëson standardet profesionale sipas fushës së ekspertimit;

b) Nëse në përmbajtjen e akt-ekspertimit janë arsyetuar drejtë dhe qartë aspektet teknike në përgjigjet e pyetjeve të kërkuara nga prokurori;

b) Nëse konkluzionet përfundimtare të akt-ekspertimit në aspektin teknik janë të mbështetura dhe harmonizuara me arsyetimet në përmbajtjen e përgjigjeve sipas secilës pyetje të shtruar në vendimin e prokurorit;

c) Nëse akti i ekspertimit ka shmangie apo deviacione teknike në përgjigjet e pyetjeve të shtruara nga prokurori i çështjes.

Neni 7

Riekspertimi në hetim ose në gjykim

1. Në rastet kur ekspertimi shpallet i pavlefshëm ose duhet të bëhet ekspertim i ri sipas ligjit, si në fazën e hetimeve paraprake, ashtu dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në gjykatën e shkallës së parë ose në gjykatën e apelit me juridiksion të përgjithshëm:

a) Në etapën e masave për fillimin e kryerjes së ekspertimit, prokurori përkatës kur e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë konsultë teknike dhe/ose konsultë metodologjike nga eksperti përkatës i shërbimit të ekspertizës, për çështje teknike apo metodologjike sipas parashikimeve në nenin 5 të këtij udhëzimi;

b) Në etapën e përfundimit të akt-ekspertimit dhe të administrimit të tij nga organi procedues, prokurori kur e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë këshillim me ekspertin përkatës të shërbimit të ekspertizës, për të analizuar dhe vlerësuar aspekte

teknike të anës formale, përmbajtjes dhe konkluzioneve të akt-ekspertimit sipas parashikimeve në nenin 6 të këtij udhëzimi.

Neni 8

Hartimi i udhëzuesve metodologjikë

Në veprimtarinë e tyre, ekspertët e shërbimit të ekspertizës hartojnë udhëzues metodiko-teknik, sipas fushave të veprimtarisë, për të unifikuar metodologjinë në aspektin teknik, si për mënyrën e përshkrimit dhe kërkimet apo pyetjet teknike në vendimin e prokurorit për kryerjen e ekspertimit, ashtu dhe për verifikimin dhe vlerësimin teknik të akt-ekspertimeve, sipas llojeve dhe veçorive të grupuara të ekspertimeve, bazuar në procedurat dhe kërkesat standarde për kryerjen e ekspertimeve, me synim për të lehtësuar dhe mbështetur në aspektin teknik dhe rritur efektivitetin, si në kryerjen e hetimeve nga oficerët e policisë gjyqësore, ashtu dhe në ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurorët.

KREU III

MËNYRA DHE FORMAT E KOMUNIKIMIT NDËRMJET PROKURORËVE ME EKSPERTËT E SHËRBIMIT TË EKSPERTIZËS

Neni 9

Mënyra dhe format e komunikimit

1. Prokurorët, sipas rastit dhe fazës së procedimit penal, konsultat teknike apo metodologjike dhe asistencën apo këshillimet me ekspertët e shërbimit të ekspertizës, i realizojnë:

a) me kërkesë formale, të dërguar zyrtarisht kur kërkohet prania e ekspertit të shërbimit të ekspertizës në prokurorinë përkatëse, ose;

b) me kërkesë nëpërmjet komunikimit elektronik, në adresat e rrjetit elektronik të brendshëm të sistemit të prokurorisë, drejtuar ekspertit përkatës të shërbimit të ekspertizës, duke parashtruar nevojën për konsultim teknik apo metodologjik dhe/ose asistencë apo këshillim në fushën përkatëse, dhe vënë në dispozicion aktet apo dokumentat e nevojshme.

2. Eksperti përkatës i shërbimit të ekspertizës, për konsultat teknike apo metodologjike dhe/ose asistencën apo këshillimet e kërkuara përgatit përgjigjen në formë “relacioni” me parashtrime, komente, vlerësime dhe sugjerimet e tij, në përgjigje të kërkimeve të prokurorit dhe në afatet ligjore të caktuara dhe/ose të dakordësuara paraprakisht me prokurorin.

3. Relacioni i ekspertit të shërbimit të ekspertizës administrohet në fashikullin e prokurorit dhe nuk mund të përdoret si provë.

4. Kur vlerësohet i nevojshëm nga prokurori, relacioni mund t'i bashkëlidhet

kërkesave apo konkluzioneve përfundimtare të tij në gjykim, si indicie dhe/ose rrethana teknike apo metodologjike që mbështet arsyetimet në kërkimet e tij në gjykimet, sipas fazave të procedimit, pranë gjykatës së shkallës së parë dhe/ose pranë gjykatës së apelit.

5. Në fazën e gjykimit, në rastet kur vlerësohet e nevojshme, nga prokurori mund të kërkohet që të asistohet nga eksperti përkatës i shërbimit të ekspertizës në seanca gjyqësore të veçanta, kur janë objekt shqyrtimi/diskutimi aspekte teknike që lidhen me ekspertimet në fushat përkatëse.

Neni 10

Ruajtja e sekretit hetimor, ndalimi i publikimit të akteve dhe mbrojtja e të dhënave personale

1. Në zbatim të këtij udhëzimi prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, ekspertët e shërbimit të ekspertizës dhe drejtuesit e prokurorive dhe të seksioneve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm marrin të gjitha masat për ndalimin e publikimit të akteve, për ruajtjen e sekretit hetimor, dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar detyrimet ligjore, si më poshtë:

a) Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale.

b) Aktet hetimore janë sekret derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Në rast nevojë për vazhdimin e hetimeve prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve. Urdhri shoqërohet me përpilimin dhe nënshkrimin e deklaratës për ruajtjen e sekretit hetimor dhe ndalimin e publikimit.

KREU IV

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, DISPOZITË KALIMTARE, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 11

Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit dhe shkak për të kërkuar fillimin e inspektimit dhe/ose hetimit disiplinor ndaj prokurorit dhe/ose drejtuesit përkatës të

prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm.

Neni 12

Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët, drejtuesit e prokurorive dhe të sektorëve dhe oficerët e policisë gjyqësore në strukturat e shërbimeve dhe të seksioneve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive dhe të seksioneve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe drejtuesi i strukturës ku përfshihet shërbimi i ekspertizës në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët informojnë periodikisht çdo tre muaj për zbatimin e këtij udhëzimi, drejtuesin përkatës, i cili informon Prokurorin e Përgjithshëm.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm.

Neni 13

Dispozitë kalimtare

Normimet e parashikuara në këtë udhëzim të përgjithshëm, si për sigurimin e asistencës dhe konsultave teknike apo metodologjike në fazat e procedimit penal, mënyrën dhe llojet e komunikimit ndërmjet prokurorëve me ekspertët e shërbimit të ekspertizës, formën/përmbajtjen e aktit përkatës dhe vlerën e përdorimit të tij, ashtu dhe për ruajtjen e sekretit hetimor, ndalimin e publikimit të akteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale në komunikimet ndërmjet prokurorëve me ekspertët e shërbimit të ekspertizës, zbatohen edhe për ekspert të fushave të tjera të shkencës të caktuar në shërbimin e ekspertizës në Prokurorinë e Përgjithshme, pas hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

Neni 14

Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

